

OUCH!

NË KËTË BOTIM..

- Përmbledhje
- Afati i një Sistemi Operativ
- Vetëmbrojtja

Fundi i Windows XP

Përmbledhje

Windows XP është treguar të jetë një nga sistemet operative më të njohura në historinë e informatikës, dhe në një moment ishte në shumicën e kompjuterëve në botë. Por Windows XP është i vjetër, dhe përkrahja nga Microsofti për të së shpejti do të ndalojë. I lëshuar për herë të parë para më shumë se dymbëdhjetë vjetësh, Microsofti ka planifikuar ta ndalojë Windows XP-në më 8 Prill 2014. Kjo nënkupton që Microsofti nuk do të lëshojë përmirësime dhe përditësime sigurie për të.

Me afro 25% të kompjuterëve në botë ende duke e përdorur Windows XP (vetëm Windows 7 është më i popullarizuar), miliona njerëz do të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku më të madh kur kjo të ndodhë. Kini parasysh, përdoruesit e tij shtëpiakë nuk janë të vetmit që do të ndikohen, sepse XP është ende i përdorur nëpër zyra, sisteme kontrolli në industri, makina bankare ATM, sisteme mjekësore, terminale shitjeje (POS), dhe pajisje tjera. Më poshtë do të përshkruajme se çfarë rreziqe do të shfaqen në momentin kur Windows XP nuk do të përkrahet më, dhe hapat që ju mund të ndërmerreni që të mbroheni.

Botuesi i ftuar

Jason Fossen është specialist për sigurinë e Microsoft Windows pranë Enclave Consulting LLC, dhe është autori i kursit gjashtëditor me emrin Securing Windows with the Critical Security Controls (SEC505) pranë SANS, si dhe falas dhuron skripta sigurie për PowerShell në faqen <http://cyber-defense.sans.org/blog/>.

Afati i një sistemi operativ

Ju mund të mos e dini, por sistemi operativ i kompjuterit tuaj ka një afat të caktuar. Prodhuesi që e krijoi atë sistem operativ do të ofrojë përditësime dhe përmirësime që shtojnë funksione të reja, e përmirësojnë stabilitetin dhe performancën, dhe e mbajnë sistemin tuaj të sigurt. Problemi qëndron në faktin se në një moment prodhuesi nuk do të vazhdojë të përkrahë sistemin tuaj operativ, dhe dikur ata do të fokusojnë resurset e tyre në teknologji tjera më të reja dhe më të avancuara. Kjo nënkupton se kur një sistem nuk përkrahet më, prodhuesi nuk lëshon më përmirësime apo përditësime, edhe atëherë kur e dinë që kompjuteri juaj është i rrezikuar dhe kriminelët kibernetikë mund të futen e të bëjnë dëme në të. Kjo do të ndodhë me Windows XP pas prillit. Edhe pse Microsofti mund ta dijë që kompjuteri juaj me Windows XP është i pambrojtur, dhe kriminelët kibernetikë janë duke abuzuar me atë dobësi, Microsofti nuk do të krijojë zgjidhje për këto probleme.

Vetëmbrojtja

Për të mbrojtur veten ju duhet të përdorni një sistem operativ që përkrahet në mënyrë aktive. Nëse mund ta përballoni si shpenzim ne ju rekomandojmë të bleni një kompjuter të ri. Shumë kompjuterë që kanë Windows XP në to nuk mund të përkrahin sistemet e reja operative. Nëse nuk mund të bleni një kompjuter të ri atëherë

Fundi i Windows XP

të paktën vendosni një sistem operativ më të ri. Për organizata, tranzicioni mund të jetë me më pak pengesa nëse migrojnë në Windows 7 në vend se në Windows 8, sepse ndërfaqja grafike apo pamja e Windows 7 është e ngjashme me Windows XP. Por, Windows 8 është më i sigurt se versionet paraprake për shkak të përmirësimeve të dukshme në softuer. Gjithashtu, ju mund të zgjidhni edhe sisteme operative nga prodhues tjerë sikurs Mac OS X i Apple. Gjithsesi, tani është koha për ndryshim, dhe nuk keni shumë kohë për të pritur. Nëse nuk keni asnjë mundësi ta ndërtoni Windows XP para prillit, atëherë kini parasysh hapat në vijim..

- Përdorni kompjuterin me Windows XP vetëm për punët dhe aplikacionet që patjetër keni nevojë. Për shembull, ndoshta ju apo organizata juaj ka një program të vjetër që hapet vetëm në XP dhe kjo është arsyeja pse nuk mund ta ndryshoni. Nëse kjo është arsyeja, atëherë mos e përdorni kompjuterin tuaj për punë tjera, si p.sh. për e-mail apo hyrje në Internet.
- Nëse duhet ta përdorni kompjuterin tuaj me Windows XP për qasje në Internet, mos e përdorni më programin Internet Explorer por kaloni në tjetër shfletues interneti sikurse janë Mozilla Firefox, Google Chrome, ose Opera. Sigurohuni që të bëni përditësime të shfletuesit në mënyrë të vazhdueshme.
- Mos përdorni më aplikacione apo programe që janë pjesë e Windows XP të cilat qasen në të dhëna nga Interneti, sikurse është Windows Media Player. Në vend të saj përdor aplikacione tjera nga prodhues tjerë që përkrahen nga prodhuesit.
- Përdorni shërbime të rrjetave sikurse është ai pa pagesë OpenDNS. Shërbimet si këto ju mbrojnë nga hapja e faqeve të njohura që janë të dëmshme. Poashtu, disa shërbime mund të dallojnë nëse kompjuteri juaj provon të lidhet në serverë të rrezikshëm si serverët Botnet Command and Control, një shenjë kjo që sistemi juaj është infektuar.
- Sigurohuni që çdo softuer sigurie që keni instaluar, si p.sh. anti-virusi, përkrahet ende për Windows XP.
- Nëse kompjuteri juaj nuk ka nevojë të lidhet në Internet (p.sh. nëse e përdorni vetëm për procesim të tekstit në word) atëherë shkyçeni nga rrjeti. Nëse duhet patjetër të jetë i kyçur në rrjet, sigurohu që të jetë i vendosur prapa një firewall, si dhe firewall lokal bllokon çdo trafik që hyn në të. Për organizata, është



Sapo Windows XP të mos përkrahet më, mënyra më e mirë për t'u mbrojtur është të kaloni në një sistem operativ që përkrahet në mënyrë aktive nga prodhuesi i tij, si dhe gjithmonë ta përditësoni atë.

Fundi i Windows XP

mirë të izoloohen të gjithë kompjuterët me Windows XP në një rrjet të ndarë, ashtu që nëse ata infektohen të mos infektojnë pjesën tjetër të organizatës.

- Rregullisht bëni kopje apo bekap të të dhënave që keni në kompjuterin me Windows XP që të jeni të përgatitur nëse dhe kur infektohet ai kompjuter. Mbani të paktën një kopje të të dhënave jashtë atij kompjuteri, p.sh. në një USB. Nëse keni nevojë t'i ktheni të dhënat, më mirë t'i ktheni ato në një kompjuter tjetër. Nëse i ktheni ato të dhëna në Windows XP, me siguri ato do të infektohen përsëri.

Nëse jeni duke përdorur Windows XP në organizatën tuaj, punëdhënësi juaj mund të marrë masa shtesë. Mos harroni, këto masa janë masa afatshkurtëra, dhe nuk janë zëvendësim për një sistem operativ të përditësuar dhe të siguruar si duhet. Herët a vonë ju do të detyroheni të kaloni në një sistem të ri.

Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen <http://www.securingthehuman.org>.

Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyes profesionale e gjuhës angleze në OSBE.

Burimet

Lajmërimi nga Microsoft EOL:

<http://www.microsoft.com/en-us/windows/enterprise/endofsupport.aspx>

OpenDNS:

<http://www.opendns.com/>

Këshilla mbi migrimin:

<http://www.zdnet.com/windows-xp-end-of-life-migration-guide-7000023800/>

OUCH: Backup & Recover:

<http://www.securingthehuman.org/ouch/2013#september2013>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 3.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në ouch@securingthehuman.org.

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis

Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano